REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA DURRËS**
**DREJTORIA LIGJORE**

# PROJEKTVENDIM

**Nr.____ DATË ____/____/2024**

**PËR**
**MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT NË NJËSITË ADMINISTRATIVE NR. 5, 6, SUKTH, MANËZ, ISHËM, RRASHBULL DHE KATUND I RI BASHKIA DURRËS, QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT PËR BANESAT INDIVIDUALE TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019.**

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Akti Normativ nr.9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me Ligjin nr. 97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.904, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe proçedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituese nga disa programe të proçesit të rindërtimit" i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.5, datë 06.01.2020 "Për përcaktimin e rregullave dhe të proçedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model" i ndryshuar, Urdhërit nr. 164, datë 01.07.2020 "Për ngritjen e komsionit të posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit", i ndryshuar, Raportit me nr. 14512 Prot., datë 12.12.2024 të Komisionit të Posaçëm miratuar nga kryetari i bashkisë, si dhe relacionit përkatës hartuar nga Komisioni i Posaçëm, kryetari i bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak Durrës të shqyrtojë në përputhje me aktet ligjore dhe,

**TË VENDOSË:**

1. Miratimin e listës së përfituesve nga programi i rindërtimit në Njësitë Administrative nr. 5,6, Sukth, Manëz, Ishëm, Rrashbull dhe Katund I Ri, Bashkia Durrës, që do të përfitojnë nga programi i procesit të rindërtimit për banesat individuale të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019, hartuar nga Komisioni i Posaçëm sipas anekseve përkatëse, pjesë përbërëse e këtij projektvendimi si më poshtë:

- ✓ Aneksi 1, "Subjektet përfituese nga programi i rindërtimit në Njësinë Administrative nr.5"
- ✓ Aneksi 2, "Subjektet përfituese nga programi i rindërtimit në Njësinë Administrative nr.6"
- ✓ Aneksi 3, "Subjektet përfituese nga programi i rindërtimit në Njësinë Administrative Sukth"
- ✓ Aneksi 4, "Subjektet përfituese nga programi i rindërtimit në Njësinë Administrative Manëz"
- ✓ Aneksi 5, "Subjektet përfituese nga programi i rindërtimit në Njësinë Administrative Ishëm"
- ✓ Aneksi 6, "Subjektet përfituese nga programi i rindërtimit në Njësinë Administrative Rrashbull"
- ✓ Aneksi 7, "Subjektet përfituese nga programi i rindërtimit në Njësinë Administrative Katund I Ri"

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike, Komisioni i Posaçëm dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës.

**DREJTORIA LIGJORE**
**Drejtor**

**Alneida Rroshi**

**KOMISIONI I POSAÇËM**
**Kryetar**

**Gentian Kallmi**

**KRYETAR**

**Emiriana Sako**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DURRËS**

**KOMISIONI I POSAÇËM**

# RELACION

**PËR**

**MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT NË NJËSITË ADMINISTRATIVE NR. 5, SUKTH, MANËZ, ISHËM, RRASHBULL DHE KATUND I RI BASHKIA DURRËS, QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT PËR BANESAT INDIVIDUALE TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019.**

Të nderuar këshilltarë,

Referuar Ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligjit nr.45/2019 "Për mbrojtjen civile", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 27.11.2019, "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë", të ndryshuar, Aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", Vendim Nr. 904, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave,të kategorive prioritare,masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve mbi disa programe të procesit të rindërtimit", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 5, datë 6.1.2020 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model", i ndryshuar, Urdhërit të Zëvendëskryetarit të Bashkisë nr. 108, datë 12.03.2020 "Për ngritjen e Zyrës së Posaçme të Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Bujqësisë, Pyjeve, Shërbimit Veterinar dhe Emergjencave Civile në Bashkinë Durrës", i ndryshuar, Urdhërit të Zëvendëskryetarit të Bashkisë nr.164, datë 26.05.2020 "Për ngritjen e komsionit të posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit" i ndryshuar me urdhërin 222 datë 06.07.2020, Raportit me nr. 14512 Prot., datë 12.12.2024 të Komisionit të Posaçëm miratuar nga kryetari i bashkisë, Komisioni i Posaçëm në bazë të dokumentacionit përkatës dhe parashikimeve të legjislacionit në fuqi pas vlerësimit të

dokumentacionit të të gjithë aplikantëve harton listën e subjekteve që përfitojnë nga programet e procesit të rindërtimit për banesat individuale të dëmtuara në Njësinë Administrative Nr. 5, Sukth, Manëz, Ishëm, Rrashbull dhe Katund I Ri, Bashkia Durrës, sipas relacionit si më poshtë vijon:
Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike, ka regjistruar dhe përpunuar aplikimet për përfitimin nga programet e rindërtimit në një sistem elektronik. Kjo zyrë ka bërë përpunimin e kërkesave të plotësuara me të dhënat dhe dokumentacionin e kërkuar sipas pikës 13, të VKM-së nr.5, datë 6.1.2020 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model", i ndryshuar, duke bërë klasifikimin e aplikantëve për përfitimin e grantit të rindërtimit për banesat individuale në Njësinë Administrative Nr. 5, Sukth, Manëz, Ishëm, Rrashbull dhe Katund I Ri, Bashkia Durrës, banesa të cilat sipas ekspertizës së thelluar hartuar nga Instituti i Ndërtimit, është vendosur prishja e tyre.

Ky dokumentacion dhe kjo listë me klasifikimin e aplikantëve i vihet në dispozicion Komisionit të Posaçëm i cili vlerëson kërkesat e subjekteve që përfitojnë nga programet e procesit të rindërtimit, në bazë të dokumentacionit përkatës dhe parashikimeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 904, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare,masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve mbi disa programe të procesit të rindërtimit" si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 5, datë 6.1.2020 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model", i ndryshuar, harton listën e subjekteve që përfitojnë nga programet e procesit të rindërtimit.

Për sa më sipër, lista e subjekteve përfituese, pjesë përbërëse e këtij raporti është si aneksi 1, 3, 4, 5, 6 dhe 7 të bashkëlidhur:

Raporti nr. 13794 prot., datë 25.11.2024 për Njësinë Administrative Nr.5: një aplikant përfitues për programin e rindërtimit të banesave individuale.

Raporti nr. 13635 prot., datë 21.11.2024 dhe raporti nr. 14110 prot. datë 06.12.2024 për Njësinë Administrative Sukth: tre aplikantë përfitues për programin e rindërtimit të banesave individuale.

Raporti nr. 13639 prot., datë 21.11.2024 për Njësinë Administrative Manëz: një aplikant përfitues për programin e rindërtimit të banesave individuale.

Raporti nr. 13436 prot., datë 21.11.2024 për Njësinë Administrative Ishëm: katër aplikantë përfitues për programin e rindërtimit të banesave individuale.

Raporti nr. 13638 prot., datë 21.11.2024 për Njësinë Administrative Rrashbull : një aplikant përfitues për programin e rindërtimit të banesave individuale.

Raporti nr. 13634 prot., datë 21.11.2024 për Njësinë Administrative Katund I Ri : 7 aplikantë përfitues për programin e rindërtimit të banesave individuale.

Për sa më sipër, bazuar në legjislacionin e sipërpërmendur dhe procedurës së ndjekur nga Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike dhe Komisioni i Posaçëm, kërkohet miratimi i listës së përfituese nga programi i rindërtimit, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësia natyrore, tërmeti i datës 26 nëntor 2019 në Njësinë Administrative Nr. 5, 6, Sukth, Manëz, Ishëm, Rrashbull dhe Katund I Ri, Bashkia Durrës, pjesë përbërëse e këtij raporti si më poshtë:

- ✓ Aneksi 1, "Subjektet përfituese nga programi i rindërtimit në Njësinë Administrative nr.5"
- ✓ Aneksi 2, "Subjektet përfituese nga programi i rindërtimit në Njësinë Administrative nr.6"
- ✓ Aneksi 3, "Subjektet përfituese nga programi i rindërtimit në Njësinë Administrative Sukth"
- ✓ Aneksi 4, "Subjektet përfituese nga programi i rindërtimit në Njësinë Administrative Manëz"
- ✓ Aneksi 5, "Subjektet përfituese nga programi i rindërtimit në Njësinë Administrative Ishëm"
- ✓ Aneksi 6, "Subjektet përfituese nga programi i rindërtimit në Njësinë Administrative Rrashbull"
- ✓ Aneksi 7, "Subjektet përfituese nga programi i rindërtimit në Njësinë Administrative Katund I Ri"

Të sigurtë në bashkëpunimin Tuaj,

KOMISIONI I POSAÇËM:

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Gentian | Kallmi | Kryetar | Robert | Dervishi | Anëtar |
| Andri | Cerri | Anëtar | Diana | Mandia | Anëtare |
| Klara | Agasi | Anëtare | Lorenc | Facja | Anëtar |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Afroviti | Manthjo | Anëtare | Albert | Bukaçi | Anëtare |
| Jurgen | Tabaku | Anëtar | Jetmir | Pupla | Anëtar |
| Edlir | Cerri | Anëtar | Kadri | Gjyli | Anëtar |
| Muharrem | Sula | Anëtar | Denis | Balla | Anëtar |

**ANEKSI 1. SUBJEKTET PËRFITUESE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.5**

| Nr. | EMER | MBIEMR | KONKLUZIONI AKTEKSPERTIZES | ZONA E TRANFERIMIT | STRUKTURA |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | RUDINA | CENGU | PRISHJE | SPITALLE | 1+1 |

ANEKSI 3. SUBJEKTET PËRFITUESE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE SUKTH

| Nr. | EMRI | EMRI | KONKLUZIONI AKTEKSPERTIZES | ZONA E TRANFERIMIT | STRUKTURA | SUBJEKTE PERFITUESE |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | GENCI | RIKA | PRISHJE | SPITALLE | 2+1 | PO |
| 2 | PAULIN | NDOJA | PRISHJE | SPITALLE | 2+1 | PO |

**ANEKSI 4. SUBJEKTET PËRFITUESE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE MANËZ**

| Nr. | EMRI | EMRI | KONKLUZIONI AKTEKSPERTIZES | ZONA E TRANFERIMIT | STRUKTURA | SUBJEKTE PERFITUESE |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | SHPETIM | KALIA | PRISHJE | MANEZ | 2+1 | PO |

**ANEKSI 5. SUBJEKTET PËRFITUESE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE ISHËM**

| Nr. | EMRI | EMRI | KONKLUZIONI AKTEKSPERTIZES | ZONA E TRANFERIMIT | STRUKTURA | SUBJEKTE PERFITUESE |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | ALFRED | BUSHAJ | PRISHJE | SPITALLE | 1+1 | PO |
| 2 | MUHARREM | SHEHU | PRISHJE | MANEZ | 2+1 | PO |
| 3 | KOL | CERRI | PRISHJE | SPITALLE | 1+1 | PO |
| 4 | KUJTIM | SALIA | PRISHJE | ISHEM | 3+1 | PO |

**ANEKSI 6. SUBJEKTET PËRFITUESE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE RRASHBULL**

| Nr. | EMRI | EMRI | KONKLUZIONI AKTEKSPERTIZES | ZONA E TRANFERIMIT | STRUKTURA | SUBJEKTE PERFITUESE |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | PERPARIM | MULLAJ | PRISHJE | PALLATI HYSEN MYSHKETA 30 | 1+1 | PO |

ANEKSI 7. SUBJEKTET PËRFITUESE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE KATUND I RI

| Nr. | EMRI | EMRI | KONKLUZIONI AKTEKSPERTIZES | ZONA E TRANFERIMIT | STRUKTURA | SUBJEKTE PERFITUESE |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | SHKELQIM | LACI | PRISHJE | SPITALLE | 1+1 | PO |